

AUTO NIVELANT



DEKOFLOOR

(0-15mm)

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	Thes, 25 Kg	1.6 (kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Autonivelues me bazë çimento gri pluhur, i përbërë nga lidhësa hidraulik me tharje të shpejtë, inerte dhe granu-lometri të seleksionuar si dhe aditivë organik special. Për ambiente të jashtme dhe të brendshme. I klasifikuar sipas standardit EN13813 Klasa C30-F10-SH 30. Produkti karakterizohet nga veti shumë të mira niveluese, punim të lehtë dhe aftësi të lartë ngjitëse me bazamentin, rezistent ndaj shtypjes dhe gërryerjes. Ofron rezistencë të lartë mekanike. I punueshëm si me dorë dhe me makineri. I rekomandueshëm për nivelimin e bazamenteve para vendosjes së lamintavëve, në këtë rast autonivelanti duhet të ketë arritur kohën e maturimit 3-7 ditë.

FUSHA E APLIKIMIT

Autonivelues për shtresa nga 0-15 mm, për bazamente të rinj dhe ekzistues. E përshtatshme për shtrimin e çdo tip dysHEMEJE të mëvonshme. Për ambiente të jashtme dhe të brendshme, si dhe për ndërtesa me trafik të limituar. I rekomandueshëm për nivelimin e bazamenteve para vendosjes së laminateve (në këtë rast autoniveluesi duhet të ketë arritur kohën e maturimit 3-7 ditë).

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

I rekomandueshëm për bazamente me bazë çimento, dysHEME me shtresë të varfër dhe betone, pllakë mbi pllakë. Të sigurohet që bazamenti të jetë i pastër, pa pluhura, vajra armaturash apo çdo substancë tjetër që ndikon në reduktimin e aftësisë ngjitëse. Të trajtohet fillimisht bazamenti me Primer D (hollimi me ujë 1 : 2).

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieni një thes 25 kg Dekofloor me 6 litra ujë me një përzierës elektrik me numër të ulët xhirosh derisa të arrini një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni masën e krijuar në qetësi për 2-3 minuta dhe më pas bëni një përzierje të vogël përpara aplikimit.





APLIKIMI

Aplikojeni produktin me një dorë të vetme nga 1-10 mm, me mallë inoksi ose prej gome. Produkti mund të aplikohet dhe me pompë suvatimi. Koha e punimit të produktit 1 orë. Përdorni rulin me gjemba për të eliminuar ajrin nga produkti. Falë aftësisë vetëniveluese Dekofloor eliminon direkt parregullsitë e vogla. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të kontrolloni përmbajtjen e lagështirës me një higrometër elektrik, duke mbajtur parasysht se ky i fundit jep vetëm vlera indikative.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e punueshmërisë: 40 minuta
Paketimi: Thasë letre 25kg në paleta me 1350 kg	Koha e pritjes për vendosjen e pllakave: Min 48 orë
Ngjyra: Gri	Rezistenca në ngjeshje: 30 N/mm ²
Kokrrizimi: 0.7 mm	Rezistenca në përkulje: ≥ 10 N/mm ²
Konsumi: 1.6 (kg/m ²)/mm trashësi	I shkelshëm pas: 12 orëve
Trashësia: Nga 1 në 15 mm/dorë, për parkete minimumi i shtresës që duhet aplikuar është 3 mm.	Koha e pritjes për vendosjen e parketeve, linoleumeve, plastikës dhe gomës: Përafërsisht 7 ditë më vonë dhe lagështia e bazamentit duhet të jetë < 2%.
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca ngjitëse pas 28 ditësh: 1.3 N/mm ²
Ujë për përzierjen: 24%	Fortësia e sipërfaqes: 30 N/mm ²



Kujdes! Mos e përdorni produktin mbi bazamente metalike dhe në vende me premisa lagështie, që të eliminohet ngritja e bazamentit. Për aplikime në trashësi me të mëdha se 10mm këshillohet që produkti të vendoset në dy duar, gjithmonë dora e dytë duhet të aplikohet kur dora e parë është plotësisht e thatë, rreth 1 ditë më vonë.